



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.1038/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS -Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Faton Bajrami, kryetar i kolegjit, Saranda Bogaj Sheremeti dhe Franciska Zhitija Ymeri, anëtare të kolegjit, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit “Fat Group” me seli në Prizren, kundër të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës në Prishtinë, me bazë juridike, anulim vendimi, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës, ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, A.nr.964/19, të datës 04.11.2020, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 12.12.2023, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e të paditurës, Administrata Tatimore e Kosovës, e dt.04.12.2020, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative-Divizioni Fiskal, A.nr.964/19, të datës 04.11.2020, **Vërtetohet**.

A r s y e t i m i

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e ankimuar, e ka aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit “Fat Group” Shpk me seli në Prizren. Nën pikën II. të dispozitivit të aktgjykimit ka anuluar pjesërisht vendim nr.57/2019 të datës 01.04.2019, të Departamentit të Ankesave të Administratës Tatimore të Kosovës në Prishtinë. Obligohet. Nën pikën III. obligohet paditësi “Fat Group” Shpk me seli në Prizren , që të paguaj TVSH shtesë në shumën prej 20,363.24€ për periudhën tatimore 2014-2018, dhe nën pikën IV. Mbesin në fuqi vlerësimet tjera të caktuara sipas Njoftim Rivlerësimeve të lëshuara nga ATK-ja- Drejtoria Rajonale Prizren dhe vendimi nr. 57/2019 i datës 01.04.2019 i Departamentit të Ankesave i Administratës Tatimore të Kosovës në Prishtinë.

Kundër këtij aktgjykimi ankesë ka ushtruar e paditura, me të cilën e konteston ligjshmërinë e aktgjykimit për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës administrative, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të së drejtës

materiale, me propozim që të aprovohet ankesa e Administratës Tatimore të Kosovës si e bazuar, aktgjykimi i atakuar të anulohet apo çështja të kthehet në Gjykatën e Shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje.

Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet në ankesë, dhe pas vlerësimit të tyre si në vështrim të nenit 49 të LKA-së, nenit 81.H,të Ligjit,nr.04/L-102, për ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit për ATK-në dhe procedurat, nr.03/L-222, dhe nenit 194, të Ligjit për Procedurën Kontestimore, (LPK), (ligj i zbatueshëm sipas nenit 63 të LKA), gjen se;

Ankesa është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se e paditura me vendimin nr.57/2019, të dt.01.04.2019, në pikën I të dispozitivit ka vendosur I. aprovohet pjesërisht si bazuar ankesa nr. 57/2019 e tatimpaguesit Fat Group Shpk me nr. të regjistrimit të biznesit (NRB) 70837617 si dhe numër fiskal (NRF) 600788197 me adresë në rrugën Tirana- pa nr. Prizren, në mbështetje të nenit 132 paragrafi 4 të Ligjit nr 05/L-031 “Për Procedurën Administrative” në lidhje me paragrafin 2 të nenit 89 të Ligjit nr, 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat” Në pikën II. ndryshohet Njoftim Rivlerësimi për Tatimin në të Ardhura të Korporatave për vitin 2017, ndërsa pjesa tjetër e vlerësimit mbetet e pa ndryshuar sipas vlerësimit të kontrollit. Pjesa e mbetur pas ndryshimeve mbetet obligim për pagesë për tatimpaguesin. Në pikën III. Procedura e ankesës nuk ndërpre në sanksionet për mos përmbushje dhe interesin për ndonjë lloj tatimi, sipas Ligjit nr.03/L-222, për Administratën Tatimore dhe Procedurat.

Kundër aktvendimit të Departamentit për ankesa të ATK, paditësi me padi inicion konflikt administrativ në Gjykatën e shkallës së parë, e cila pas mbajtjes së seancës publike me dt.04.11.2020, në prani të përfaqësuesit të autorizuar të paditësit e në mungesë të përfaqësuesit të autorizuar të palës së paditur dhe administrimit të provave si në procesverbal të shqyrtimit kryesor, gjatë vlerësimit të ligjshmërisë së vendimit të organit të paditur, në kuptim të nenit 81 G të ligjit nr.04/L-102, bien aktgjykimin e ankimuar, me të cilin e aprovon pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit, dhe e ndryshon pjesërisht vendimin kontestues të organit të paditur duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të cekur si më lartë.

Në arsyetim të aktgjykimit të ankimuar, ndër të tjera është theksuar se; nga provat e administruara gjykata konstaton se e paditura ka vepruar pjesërisht drejtë kur me vendimin kontestues ka aprovuar pjesërisht ankesën e paditësit dhe ka ndryshuar Njoftim rivlerësimet e kontrollit, për tatimin në të Ardhura të Korporatave për vitin 2017. Gjykata ka konstatuar se e paditura gjatë rivlerësimit të çmimit të shitjes së lokaleve afariste nuk ka bërë një vlerësim të drejtë tatimor për periudhën 2014-2018 me c ‘rast paditësit i është rrit qarkullimi shtesë dhe është ngarkuar pa të drejtë me tatim shtesë në shumë prej 77,497.25€. gjykata nga provat e administruara konstaton se e paditura nuk i ka mbështetur në prova materiale konstatimet e saj në konflikt administrativ gjyqësor se paditësi i ka nën deklaruar çmimet e shitjes së lokaleve afariste pasi që nuk ka ofruar prova apo informata që bazohen në çmimin mesatar të shitjes

nga bizneset tjera apo se ky vlerësim është bërë në bazë të vlerës së hapur të tregut sikurse parashihet në nenin 46 të Ligjit 03/L-222 dhe nenin 24 të Ligjit 03/L-146 i ndryshuar dhe i plotësuar me ligjin 3/L-197 dhe Ligjin 4/L-108 për TVSH-në respektivisht të Ligjit 05/L-037 për TVSH. E paditura nuk ka provuar para gjykatës se paditësi ka deklaruar çmime tjera shitëse nga deklaramet e shitjes të paraqitura në këtë periudhë tatimore. Gjykata për ti vërtetuar të gjitha provat e nxjerra në procedurën administrative dhe pretendimet e palëve ndërgjyqëse ka bërë administrimin e provave edhe përmes ekspertizës financiare të propozuar nga pala paditëse në seancën gjyqësore. Në ekspertizën financiare të datës 28.06.2020 dhe në seancën e shqyrtimit kryesor, eksperti ka dhënë mendimin profesional se rritja e qarkullimit mbi bazën e banesave të shitura në vitin 2014 korrespondon me vlerësimin e kontrollit të paditurës ATK-së, pasi që paditësi ka caktuar çmimin më të ulët të shitjes kundrejt çmimit të tregut të lirë referuar shitjeve me kompensim subjektit Fetoshi dhe personave të tretë. Ndërsa sa i përket çmimit të shitjes së lokaleve afariste, ekspertiza financiare ka caktuar se qarkullimi shtesë në mbështetje të çmimit të tregut të lirë i përlllogaritur për vitet 2014-2018 duhet të jetë në vlerën prej 141,621.12€ ndërsa TVSH shtesë e përlllogaritur mbi këtë bazë me të cilën do të duhej të ngarkohet paditësi është në shumën prej 20,363.24€. Nga provat e administruara si kontratat e shitjes, librat e shitjes, faturat tatimore, informatat nga shitja e lokaleve nga palët e treta të ofruara nga paditësi, përlllogaritja e TVSH-së shtesë duke aplikuar koeficientet 7.24 për vitet 2014 dhe 2015 ndërsa 6.56 për vitet 2017 dhe 2018 kriteret të parapara me Udhëzimin Administrativ 02/2015. Gjykata ia dha besimin ekspertizës lidhur me çmimin real të shitjes së lokaleve afariste për periudhën 2014-2018 ashtu që qarkullimi shtesë që duhet ti vendoset paditësit është vlera prej 141,621.12€, vlerë kjo e cila duhet të shpërndahet ndër vite, sipas viteve akruale të krijimit të obligimit dhe atë 2014, 2015, 2017, 2018, ndërkaq që obligimi i TVSH-së shtesë në këtë rast duhet të jetë 20,363.34€. gjykata ka lënë në fuqi vlerësimet tjera të caktuara sipas Njoftim Rivlerësimeve të lëshuara nga ATK-ja-Drejtoria Rajonale Prizren dhe Vendimi nr. 57/2019 i datës 01.04.2019 i Departamentit të Ankesave të Administratës Tatimore të Kosovës në Prishtinë.

Dhoma e Shkallës së Dytë, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, i pranon në tërësi si të drejta dhe ligjore konkludimet juridike të gjykatës së shkallës së parë sa i përket gjendjes faktike të çështjes, e gjithashtu aktgjykimi i ankimuar nuk është i përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të Ligjit për konflikte administrative të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i ekzaminon sipas detyrës zyrtare si në vështrim të nenit 49 të LKA dhe 194 të LPK. Kolegji vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur gjatë vlerësimit të ligjshmërisë së aktvendimit të kontestuar si në vështrim të nenit 41 të LKA, në drejtim të thënieve në padi, përgjigjes në padi, si dhe provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor dhe ka vlerësuar drejtë, se kërkesë padia e paditësit është pjesërisht e bazuar, duke e anuluar pjesërisht vendimin e organit të paditur. Andaj nuk janë të qëndrueshme pretendimet në ankesë se nga gjykata e shkallës së parë janë bërë shkelje të dispozitave të procedurës administrative sepse procedura në tërësi është zhvilluar në baza ligjore, janë administruar prova të mjaftueshme të palëve ndërgjyqëse të shtjelluara në tërësi si në arsyetim të aktgjykimit lidhur me mënyrë e vendosjes së çështjes, nga rezulton se gjykata e shkallës së parë nuk ka bërë shkelje të dispozitave të LKA-së dhe LPK-së, gjatë vlerësimit të ligjshmërisë së vendimit të organit të paditur.

Pretendimet ankimore të paditurës sipas shkaqeve të cekura më lartë, si dhe theksimet ndër të tjera në arsyetim të saj, se; “gjkata me rastin e vendosjes nuk ka marrë për bazë provat e ofruara nga përfaqësuesit e ATK-së, kundërshtimin e ekspertizës financiare të datës 23.10.2020 por është bazuar në ekspertizën financiare duke ja falur besimin sit ë drejtë dhe të bazuar. Kolegji i shqyrtoi me kujdes dhe të njëjtat i refuzon si të pa bazuara në prova dhe fakte të dëshmuara dhe gjen se aktgjykimi nuk është i përfshirë me shkelje procedurale dhe ligjore siç pretendohet në ankesë, sepse e njëjta ka shqyrtuar padinë, ka mbajtur seancë të shqyrtimit kryesor në praninë e përfaqësuesit të autorizuar të palës paditëse e në mungesë të paditurës, si në vështrim të nenit 41 të LKA. Gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të administruara në seancën kryesore, ekspertizës financiare, si dhe shkresave të tjera ka nxjerrë prova të mjaftueshme si në vështrim të nenit 38 të LKA-së, dhe në mënyrë të plotë dhe të drejtë e ka vërtetuar gjendja faktike, me aprovimin pjesërisht të kërkesë padisë, duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit, bazuar në faktet e paraqitura si në arsyetim të aktgjykimit të mbështetura në dispozitat ligjore tatimore.

Nga tërë kjo që u cek më lartë dhe mbi këtë gjendje faktike, kjo gjykatë konsideron se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, ngase nuk është cenuar ligji në dëm të paditurës. Prandaj, pretendimet ankimore në ankesë se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar edhe të drejtën materiale në dëm të paditësit, ky kolegji nuk i aprovoi, sepse vlerësoi se të njëjtat janë të paqëndrueshme dhe të pa bazuara për tu aprovuar ankesa, dhe se janë të pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuar edhe nga gjykata e shkallës së parë. Sepse, aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë, është i qartë dhe i kuptueshëm si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe kjo gjykatë, andaj, ankesa e të paditurës u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm. Duke marrë parasysh se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale, me rastin kur ka aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë dhe ka anuluar pjesërisht aktvendimin e të paditurës, e pasi që me pretendimet tjera ankimore të përsëritura, të njëpasnjëshme, një aktgjykim i tillë nuk mund të vihet në pyetje, ankesa e të paditurës, u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e Shkallës së Dytë
K.DH.SH.II.nr.1038/22, me datë 12.12.2023

Kryetar i kolegjit,
Faton Bajrami